



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Shkolla e përgjithshme JOPUBLIKE “IBRAHIM KODRA”

Durrës

Tel +35552236061/+355694053567

e-mail: [info@shkollaibrahimkodra.com](mailto:info@shkollaibrahimkodra.com)

Për përdorim të brendshëm

RREGULLORE (A)

Për **marrëdhëniet reciproke** (të drejtat dhe detyrimet reciproke) **ndërmjet shkollës së përgjithshme jopublike “IBRAHIM KODRA” dhe nxënësit, prindit apo personit përgjegjës të tij (për nxënësit që rregjistrohen në klasat VI – XII)**

Neni 1  
Të drejtat e nxënësit

Nxënësi i shkollës jopublike “I. Kodra”, ka këto të drejta, *gjatë gjithë kohës si nxënës i kësaj shkolle*.

- 1- Të kërkojë *(verbalisht ose me shkrim)* tek Administratori i shkollës, ***kushte normale për mësimdhënie*** në klasë, ***kushte normale në ambientet e tjera të përbashkëta të shkollës***, si dhe ***kushte të sigurt dhe të përshtatshme higjienike*** në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës, etj. Pra, ka të drejtë të kërkojë nga shkolla jopublike “I. Kodra” kushtet që duhet të jenë në përputhje me Dispozitat Normative në fuqi nga MAS, për shkollat e ciklit të lartë të arsimit 9-vjeçar, si dhe të arsimit të ciklit të lartë parauniversitar.
- 2- Të kërkojë *(verbalisht ose me shkrim)* ***zbatimin e programit mësimor vjetor***, në përputhje me programin e përcaktuar nga MAS.
- 3- Të kërkojë ***cilësinë e duhur të mësimdhënies***.
- 4- Të kërkojë *(verbalisht ose me shkrim)* ***zbatimin e rregjimit ditor të mësimdhënies***, pra, zbatimin rigoroz të kohëve të përcaktuara për mësim dhe pushim. ***Ora e mësimi nuk cënohet për asnjë arsye***.
- 5- ***Të denoncojë*** *(verbalisht ose me shkrim)* tek Administratori i shkollës ***vlerësimet jokorrekte*** të njohurive të tij në mësim nga mësuesit *(mësimdhënësit)*. Në këtë rast, ***kërkohet që ankimi i tij të jetë i argumentuar dhe i faktuar***. Këto denoncime mund të bëhen edhe në rastet kur nxënësi ***vëren vlerësim jokorrekt (joreal)*** nga mësuesit *(mësimdhënësit)*, ***edhe për nxënësit e tjerë të klasës***.
- 6- Të kërkojë tek Administratori i shkollës, në bashkëpunim dhe në mirëkuptim me nxënësit e klasës ku bën pjesë, ***organizimin e veprimtarive jashtëshkollore*** *(të mundshme)*, në përputhje me moshën, aftësinë, si dhe interesin e tyre intelektual, sportiv, etj.
- 7- ***Të denoncojë*** *(verbalisht ose me shkrim)* tek Administratori i shkollës ***rastet e sjelljeve jo të rregullta, të palejueshme dhe jo sipas normave të përcaktuara nga shkolla jopublike “I. Kodra”, për nxënësit e klasës apo të shkollës, për mësuesit (mësimdhënësit) dhe për çdo person tjetër, që ndodhet në ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës***.
- 8- ***Të denoncojë*** *(verbalisht ose me shkrim)* tek Administratori i shkollës ***rastet e abuzimeve dhe të korrupsionit në Olimpiadat Rajonale dhe ato Kombëtare***, për moskorrektësitë e zhvillimit të konkurrimit, si dhe moskorrektësitë e vlerësimit të testeve të zhvilluara me shkrim.
- 9- ***Të kërkojë*** *(verbalisht ose me shkrim)* tek Administratori i shkollës jopublike “I. Kodra” ***shkëputjen e tij nga kjo shkollë*** *(nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare ndaj shkollës jopublike “I. Kodra”)* dhe ***të shpjegojë arsyet e largimit***, në prani të prindit apo të personit përgjegjës për të.
- 10- Nxënësi ***gëzon të drejtën e votimit të lirë për zgjedhjen e forumeve përfaqësuese*** të tyre në shkollën jopublike “I. Kodra”, forume që përcaktohen sipas ligjit ***për arsimin me kohë të plotë***, për shkollat, të miratuara nga MAS, ***referuar shkollave të ciklit të lartë të arsimit 9-vjeçar, si dhe të arsimit të ciklit të lartë parauniversitar***.
- 11- Nxënësit e shkollës jopublike “I. Kodra” ***gëzojnë po ato të drejta, njësoj si në shkollat publike, të përcaktuara nga Dispozitat Normative në fuqi***.

## Neni 2

### Detyrimet e nxënësit

Në shkollën jopublike "I. Kodra", nxënësi duhet të zbatojë këto detyrime <sup>gjatë gjithë kohës si nxënës i kësaj shkolle</sup>.

- 1- **Nxënësi është i detyruar** të respektojë dhe të zbatojë **Rregulloren e shkollës jopublike "I. Kodra"**.
- 2- **Nxënësi është i detyruar** të zbatojë me përpikmëri **orarin e mësimëve**, të respektojë **disiplinën e zhvillimit të mësim**, si dhe të respektojë **detyrimet e përcaktuara në programin mësimor të shkollës jopublike "I. Kodra"**.
- 3- **Ora e mësimi është 45 minuta. Pushimet ndërmjet orëve të mësimi janë 5 minuta**, që nxënësit dhe mësuesit të përgatiten për orën pasardhëse të mësimi.
- 4- **Paraqitja e nxënësit në shkollë** kërkohet **10 minuta përpara fillimit të mësimi** <sup>(në orën 7.50)</sup>. Çdo paraqitje me vonesë e nxënësit në shkollën jopublike "I. Kodra" **duhet patjetër të justifikohet** tek mësuesi kujdestar. Në shkollën jopublike "I. Kodra" **lejohet vetëm 2 (dy) vonesa në muaj të nxënësit**. Në raste të paraqitjes me vonesës të nxënësit në shkollë, **mësuesi kujdestar njofton menjëherë prindin apo personin përgjegjës** të nxënësit për vonesat tij në shkollë. **Kërkohet nga nxënësi mospërsëritja e gabimit** <sup>paraqitjes me vonesës të nxënësit në shkollë</sup>, në të kundërt, ndaj nxënësit do të merren **masa administrative**, deri në përjashtimin e tij nga shkolla.
- 5- Nxënësi është **i detyruar** të sigurojë **bazën e nevojshme materiale që kërkohet nga mësimdhënësi**.
- 6- **Nxënësi dhe prindi apo personi përgjegjës i tij, janë të detyruar të njoftojnë mësuesin kujdestar apo administratën e shkollës** nëse **do të mungojë në mësim apo në veprimtarinë mësimore**, të programuar nga shkolla. Për çdo mungesë nxënësi është **i detyruar të paraqesë në shkollë dokumentin justifikues** (raport mjekësor, etj.). Nëse nuk ka dokument justifikues, atëherë nxënësi i kërkon prindërve apo personit përgjegjës për të, **të bisedojnë me mësuesin kujdestar të tij dhe të japin arsytimin e mungesës së nxënësit në mësim**.
- 7- Nxënësi që plotëson **30 mungesa** <sup>(30 orë mësimore)</sup> **pa arsye, paralajmërohet** për përjashtim nga shkolla. Nëse nxënësi plotëson **45 mungesa pa arsye** <sup>(45 orë mësimore)</sup>, atëherë nxënësi **përjashtohet** nga shkolla.
- 8- Në shkollën jopublike "I. Kodra" **nuk lejohet të frekuentojë mësimin nxënësi që preket dhe vuan nga sëmundje ngjitëse** si gripi, difteria, tifo, tuberkulozi, diareja, bakteret EHEC apo nga çdo sëmundje tjetër ngjitëse.
- 9- Në zbatim të urdhërit të MAS, **ndalohet kategorikisht përdorimi i celularëve gjatë orës së mësimi**, si edhe në ambientet e brendshme të shkollës. Për çdo urgjencë të nxënësit, shkolla jopublike "I. Kodra" ka vënë **në dispozicion telefonin fiks +355 52 236061 dhe telefonin celular +355 69 405 3567**.
- 10- Nxënësi i shkollës jopublike "I. Kodra" **duhet të prezantojë kudo sjellje me edukatë, të kulturuar dhe me mirësjellje e respekt**, si në ambientet mësimore, ashtu edhe në ambientet e përbashkëta të shkollës <sup>(të brendshme dhe të jashtme)</sup>. **Ky qëndrim nga nxënësi duhet të respektohet dhe të zbatohet edhe jashtë orarit të qëndrimit të tij në shkollën jopublike "I. Kodra"**. **Kudo, si në shkollë, si jashtë saj, nxënësi i shkollës jopublike "I. Kodra" përfaqëson me sjelljen dhe qëndrimin e tij, edhe kulturën e sjelljes që kërkohet nga kjo shkollë**.
- 11- **Veshja dhe paraqitja e jashtme** e nxënësit duhet të jetë **korrekte dhe serioze**, në përshtatje me moshën. Ndalohet frekuentimi i shkollës jopublike "I. Kodra" nga **nxënësit** <sup>(dhe mësuesit)</sup> me **veshje të papërshtatshme**. Veshjet që nuk janë të përshtatshme për moshën, **provokuese dhe shqetësuese** për nxënësit e tjerë të shkollës, etj. **nuk lejohen në shkollën jopublike "I. Kodra"**. <sup>(shih shënim (1))</sup>
- 12- Nxënësi i shkollës jopublike "I. Kodra" **duhet të mbajë qëndrim korrekt dhe përgjegjës** ndaj kolegëve të klasës, nxënësve të tjerë të shkollës, si dhe ndaj mësuesve dhe punonjësve të administratës së shkollës, etj.
- 13- Nxënësit të shkollës jopublike "I. Kodra" **i ndalohet rreptësisht përdorimi ndaj kujtdo i dhunës fizike apo psikologjike**. Konfliktet fizike nga nxënësit ndaj njeri-tjetrit, si dhe ndaj kujtdo personi tjetër, janë rreptësisht **të papranueshme dhe të ndaluara** në ambientet e shkollës jopublike "I. Kodra". <sup>(shih shënim (1))</sup>
- 14- Nxënësit të shkollës jopublike "I. Kodra" **nuk i lejohet kategorikisht të jetë duhanpirës, përdorues i pijeve alkoolike, i drogës**, etj. Përdorimi i këtyre elementeve (duhan, pije alkoolike, drogë) tregojnë vullnet të dobët **të nxënësit përdorues, dëmtojnë shëndetin fizik dhe intelektual të tij**, si dhe **demonstrojnë në çdo ambient** <sup>që nxënësit frekuentojnë</sup>, **një shembull publik jo të mirë, aspak të dëshëruar dhe të pëlqyer nga shkolla jopublike "I. Kodra"**.
- 15- Nxënësit të shkollës jopublike "I. Kodra", **i ndalohet rreptësisht** edhe mbajtja e cigareve, pijeve alkoolike dhe e lëndëve narkotike (droga të ndryshme dhe të çdo lloji, etj.) gjatë kohës së qëndrimit të tij në këtë shkollë. <sup>(shih shënim (1))</sup>
- 16- Nxënësit të shkollës jopublike "I. Kodra" **nuk i lejohet kategorikisht** të mbajë me vehte në shkollë dhe kudo, **çfarëdo lloj arme**, qoftë edhe **armë e ftohtë** (thika, kaçavida me teh të gjatë dhe të mprehtë, etj.). **Ndalohen rreptësisht edhe përdorimi nga nxënësi në ambientet e shkollës jopublike "I. Kodra" i armëve të çdo lloji dhe i mjeteve me rrezik për jetën** (thikë, etj.) <sup>(shih shënim (1))</sup>
- 17- Nxënësi që vjen në shkollën jopublike "I. Kodra" **i dehur**, apo **i droguar**, apo **i pajisur me armë, përjashtohet pa paralajmërim** nga shkolla.
- 18- Nxënësi duhet **të kujdeset, të ruajë dhe të mirëmbajë bazën materiale** ekzistuese në klasat, kabinetet mësimdhënëse, si dhe të ambienteve të përbashkëta të shkollës jopublike "I. Kodra". **Çdo dëmtimi qëllimshëm** <sup>dhe i pranuar nga nxënësinë prani të prindit apo të personit përgjegjës për të</sup> <sup>(nga prindi apo nga të personi përgjegjës për të)</sup>, do të zhdëmtohet nga nxënësi **në vlerë të barabartë me vlerën e dëmit të shkaktuar**. Për raste të tilla, **nxënësi mund edhe të ndëshkohet me masa administrative nga Administratori i shkollës**. <sup>(shih shënim (1))</sup>
- 19- Çdo nxënësi të shkollës jopublike "I. Kodra" **i sygjerohet të mos marrë me vete në shkollë sende me vlerë** (shuma monetare të konsiderueshme, objekte apo sende artistike, monumentale, etj.). Shkolla jopublike "I. Kodra" **nuk**

**përgjigjet në rastet e humbjes së tyre, si dhe nuk përgjigjet për zhdëmtimet e tyre** (nëse sendet me vlerë <sup>(të sipërtreguara)</sup> dëmtohen apo përvetësohen nga keqdashës).

- 20- Nxënësi duhet **të kujdeset dhe të ruajë pastërtinë** në klasat dhe kabinetet mësimdhënëse, si dhe në çdo ambient të përbashkët të shkollës jopublike “I. Kodra”.
- 21- Nxënësi duhet të mos dëmtojë objektet e vendosura në ambientet e përbashkëta dhenë ambientet ku zhvillohet mësim, si vazo të ndryshme, çelsat dhe llampat elektrike, banka, stenda, laboratorë, etj. Gjithashtu, **nxënësit i ndalohe rreptësisht të prekë** <sup>(me dorë apo mjet tjetër)</sup> dhe të dëmtojë **pikturat e varura** në korridorët dhe ambientet e brendshme të shkollës, etj. **Në të kundërt do të kërkohet zhdëmtimi i tyre në vlerën monetare respektive.**
- 22- Nxënësi **gëzon të drejtën për t’u bërë anëtar i bibliotekës** së shkollës jopublike “I. Kodra”.

Shënim (1): (i vlefshëm për pikat (11), (13), (15), (18) të Nenit 2)

*Në të tilla raste, mësuesi kujdestar i nxënësit njofton dhe thërret menjëherë prindët ose personin përgjegjës të tij për ngjarjen apo fenomenin e shkaktuar nga nxënësi në shkollë. Nëse nxënësi nuk reflekton, më keq, vazhdon ta përsërisë qëndrimin apo veprimin e tij, atëhere ai rrezikon të përjashtohet nga shkolla jopublike “I. Kodra”.*

### Neni 3

#### Të drejtat e prindërve apo të personit përgjegjës të nxënësit

- 1- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit deklarojnë se **pranojnë parimet dhe kriteret e vendosura** në shkollën jopublike “I. Kodra” për arsimimin dhe edukimin e nxënësve të saj (fëmijëve të tyre).
- 2- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **gëzojnë të drejtën** dhe janë të mirëpritur **të japin kontributin e tyre** jo vetëm për realizimin, por edhe për **përmirësimin e mëtejshëm të parimeve dhe të kriterëve të vendosura** në shkollën jopublike “I. Kodra”.
- 3- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **gëzojnë të drejtën t’i kërkojnë Administratorit** të shkollës jopublike “I. Kodra”, <sup>(gojarisht ose me shkrim)</sup> individualisht apo nëpërmjet **Këshillit Prindërve** të shkollës, **çdo vërejtje apo sygjërim** për përmirësimin e mësimdhënies, të veprimtarive jashtëshkollore, kushteve të sigurisë dhe të higjenës (pastërtisë së ambienteve) në shkollë, forcimin e mëtejshëm të normave për edukim më të mirë të nxënësve, për vlerësimet jokorrekte të mësuesve (nëse argumentohen), etj.
- 4- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **gëzojnë të drejtën të informohen menjëherë** (në tel / cel / e-mail) nga mësuesi kujdestar i nxënësit apo nga sekretaria e shkollës, nëse **fëmija e tyre është sëmurë**, për **mosparaqitjen** <sup>(mungesën)</sup> e fëmijës së tyre në mësim (në shkollë), por edhe **për çdo shkelje nga fëmija e tyre të normave dhe të rregullave** të vendosura nga shkolla jopublike “I. Kodra”.
- 5- Nëse nxënësi **nuk ka dokument zyrtar** (raport mjekësor, etj.) **për të justifikuar mungesën e tyre në shkollë**, atëhere prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **duhet të justifikojnë** <sup>(preferohet me shkrim)</sup> mungesën e fëmijës së tyre në shkollë, tek mësuesi kujdestar apo sekretaria e shkollës.
- 6- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **informohen dhe njoftohen nga administrata e shkollës jopublike “I. Kodra” dhe mësuesit kujdestarë të tyre, për veprimtarinë jashtëshkollore që organizon shkolla**. Nëse veprimtaritë do të zhvillohen larg qytetit të Durrësit (mundet edhe me kohëzgjatje më shumë se 24 orë), atëhere mësuesit kujdestarë njoftojnë prindin apo personin përgjegjës të çdo nxënësi, për kujdestarët e caktuar nga shkolla <sup>(që do të shoqërojnë nxënësit)</sup> dhe që **do të jenë përgjegjës** për nxënësit që marrin pjesë në veprimtarinë jashtëshkollore. I njëjti veprim kryhet edhe për aktivitetet ujore në plazh apo në pishina. Në veprimtaritë jashtëshkollore, brenda dhe jashtë Rajonit të Durrësit, **nxënësit mund të udhëtojnë me automjete të prenotuara nga shkolla apo edhe me mjete të transportit publik**.
- 7- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **i njohin të drejtën shkollës jopublike “I. Kodra” që në veprimtaritë shkollore dhe jashtëshkollore, nxënësve të shkollës t’u bëhen fotografi dhe rregjistrime audio sepse ato do të ruhen në arkivën e shkollës**.
- 8- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **gëzojnë të drejtën e votimit të lirë, si dhe të kandidimit vullnetar, në zgjedhjen e organeve përfaqësuese** të tyre në shkollën jopublike “I. Kodra”, si p. sh. **Këshilli i Prindërve**, etj.
- 9- **Shoqata e Prindërve** ka të drejtë të marrë pjesë në organizimin e jetës së shkollës jopublike “I. Kodra”, **konform ligjit përkatës të arsimit**.
- 10- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **gëzojnë të drejtën të ftohen** nga shkolla jopublike “I. Kodra” **për të marrë pjesë në ceremonitë që organizon shkolla**, si p. sh. për vlerësimin e nxënësve më të mirë dhe me rezultatet mësimore më të mira, për fituesit në Olimpiada, në ceremonitë përmbyllëse (të maturës) të çdo viti akademik, për vlerësimin e nxënësit dhe mësuesit më të mirë të vitit, etj.

### Neni 4

#### Detyrimet e prindërve apo të personit përgjegjës të nxënësit

- 1- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë detyrimin dhe përgjegjësinë të bashkëpunojnë ngushtësisht me stafin mësimdhënës dhe administratën e shkollës** jopublike “I. Kodra” për mbarëvajtjen dhe marrëdhëniet korrekte të fëmijës së tyre në shkollë.
- 2- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë detyrimin të respektojnë të drejtat dhe detyrimet** që përcakton kjo Rregullore e brendshme e shkollës jopublike “I. Kodra”.
- 3- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë përgjegjësinë e kontrollit të fëmijës së tyre** për kohën e lirë të tyre <sup>(kohën që nxënësi nuk është në shkollën jopublike “I. Kodra”)</sup>, pra për kohën jashtë orarit mësimor dhe veprimtarive jashtëshkollore të shkollës.
- 4- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë detyrimin e pjesëmarrjes në takimet prindër-mësues** që njoftohen dhe **organizohen** nga shkolla jopublike “I. Kodra”.
- 5- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë detyrimin të shprehin** <sup>gojarisht ose me shkrim</sup>, individualisht apo nëpërmjet **Bordit të Prindërve** të shkollës, **çdo vërejtje apo sygjërim për përmirësimin e mësimdhënies, të veprimtarive jashtëshkollore, kushteve të sigurisë dhe të higjienës (pastërtisë së ambjenteve) në shkollë, forcimin e mëtejshëm të normave për edukim më të mirë të nxënësve, për vlerësimet jokorrekte të mësuesve (nëse argumentohen), etj.**
- 6- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë përgjegjësinë e kontrollit të fëmijës së tyre për frekuentimin pa mungesa në procesin mësimor** dhe edukues të shkollës jopublike “I. Kodra”.
- 7- Prindët apo personi përgjegjës i nxënësit **kanë përgjegjësinë të shlyejnë detyrimet financiare ndaj shkollës jopublike “I. Kodra”**, brenda afateve të përcaktuara në **AKT-MARRËVESHJEN** ndërmjet tyre.

## Neni 5

### Të drejtat e Administratorit të shkollës

- 1- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën ekskluzive për të drejtuar dhe kontrolluar të gjithë veprimtarinë** e shkollës jopublike “I. Kodra”, atë **të mësimdhënies, të organizimit të veprimtarive jashtëshkollore, të administrimit të financave të shkollës, etj.**
- 2- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën e administrimit të marrëdhënieve me prindët apo me personat përgjegjës të nxënësve**, të organizimit të takimeve prindër-mësues, të organizimit të ceremonive në shkollë, të organizimit të veprimtarive kulturore, artistike dhe sportive në shkollë, etj.
- 3- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën e administrimit të marrëdhënieve me Këshillin e Prindërve** të shkollës.
- 4- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën vendimarrëse për masat administrative ndaj nxënësve** <sup>(dhe mësuesve)</sup> të shkollës.
- 5- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën vendimarrëse për masat penalizuese financiare** ndaj nxënësve (prindërve apo personit përgjegjës të nxënësit) **për moskryerjen e pagesave të tyre të detyrueshme ndaj shkollës jopublike “I. Kodra”**.
- 6- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **të drejtën vendimarrëse për masat penalizuese financiare** ndaj nxënësve (prindërve apo personit përgjegjës të nxënësit), **për dëmet që shkaktohen me qëllim apo nga pakujdesia e nxënësit.**

## Neni 6

### Përgjegjësitë e Administratorit të shkollës

- 1- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **përgjegjësinë për respektimin** në këtë shkollë të Dispozitave ligjore dhe normative për arsimin me kohë të plotë, të miratuara nga MAS, referuar shkollave të ciklit të lartë të arsimit 9-vjeçar, si dhe të arsimit të ciklit të lartë parauniversitar.
- 2- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **për detyrë të sigurojë** kushte normale mësimi, të sigurta dhe higjienike për nxënësit e shkollës.
- 3- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **për detyrë të punësojë mësues me kualifikime profesionale dhe pedagogjike në përputhje me objektivat e shkollimit arsimor sa më cilësor** të nxënësve të kësaj shkolle, si dhe sipas kritereve dhe udhëzimeve të MAS.
- 4- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” ka **për detyrë të sigurojë zbatimin e kurrikulave dhe të programeve mësimore**, si dhe të bëjë ndryshimet përkatëse të tyre, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore dhe udhëzimet e MAS.
- 5- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra” është **i detyruar të pajisë nxënësit me dëftesa sipas standarteve të miratuar nga MAS**
- 6- Shkolla jopublike “I. Kodra” **gëzon të drejtën e kqyrjes** së seriozitetit të çdo nxënësi në përgatitjen e tij mësimore dhe sistematike në çdo lëndë, progresin e tij në nivelin e përgatitjes në mësim, etj.
- 7- Administratori i shkollës jopublike “Ibrahim Kodra”, **në sezonin e rregjistrimeve të nxënësve të rinj në shkollë**, është **i detyruar të shpallë pagesat dhe tarifatat e shërbimit** për vitin akademik (shkollor) në vijim

**Administratori i shkollës  
JASHAR ARRËZA**